



# MANIFEST

Politika është përpjekje. Fjala bëhet vepër, vepra flet e merr rrugë ndër njerëz. Ajo është mendimi i fuqizuar kur manifestohet me pasion e bindje. E reja që ngjan, besnikëria që i qëndron kohës, mendimi që zgjidh e qartëson.

Politika si demokraci është fusha e kushtit njerëzor. E njeriut të çfarëdoshëm, bujk, këpucëtar apo filozof. Punët publike nuk janë profesion, prandaj qytetar është secili.

Një shprehje e bindjes për veprim politik tek ne rëndom do të fillonte nga veta e tretë. Populli është arsyeja e ekzistencës, kurse ne thjesht artikulesit e vullnetit të tij. I shkelur nga brenda dhe jashtë, ai është në gjendje të mjerueshme. Qenia burimore e tij është tjetërsuar, kurse aspiratat e tij janë harruar. Në fund, logjika do të vazhdonte, populli i realizuar, realizon aspiratat e përvetëson origjinën.

Por, gjithë problemi është kur s'është ky fundi. Kur zhvillimet marrin rrugë tjetër dhe kjo matricë me logjikë vetëpërbushëse nuk mund ta marrë dot realitetin në punë. Atëherë, kemi imponim të dhunshëm, eliminim e instrumentalizim të elementeve që janë pengesa irrelevante drejt fundit të garantuar nga shkenca e historia.

Ne nuk jemi pararoja që ka qasje në fatet e historisë. Në vend të rehatisë së rrezikshme që ta jep kjo garancë, kemi zgjedhur ankthin e rimendimit të vazhdueshëm – vetë dënimin e lirisë.

Ne jemi armiq të e popullit. Do t'i luftojmë zëdhënësit, ata që bartin prokurën e tij. Ngado që të vijë kjo prokurë: nga lartësia e providencës, nga domosdoshmëria historike, apo nga rrënjët pellazge. Jemi këtu për të mos rreshtur së gabuari. Vetëm kështu politika dhe e vërteta nuk e humbin marrëdhënien mes tyre.

Refuzojmë kategorikisht çdo diskurs mbi fundin e historisë pavarësisht nga cili krah vjen ai. Nga ata që këtë fund e panë pas rënies së murit të Berlinit përmes kombinimit të demokracisë liberale me neoklasicizmin ekonomik; njëjtë edhe ata që duke njësuar shkencën dhe politikën kanë



ontologjizuar rolin e subjektit dhe shkallëzuar fazat deri tek shpagimi i madh - zgjidhja përfundimtare e çdo kontradikte.

Kosova po kalon nga një regjim neoliberal tek një udhëheqje me theks popullist e mendësi totalitare. Mendësia e turmës, sulmi ndaj të dobtëve e pakicave tashmë janë sinjale shqetësuese që tregojnë për imperativin e ndërhyrjes për demokratizimin e shoqërisë.

PSD vepron nën trumbetën e "ndryshimit të madh". Këtij ndryshimi i japim thonjëza e fusnotë sepse bartet nga shenjuesi i dobët "antikorrupsion". Korrupsioni e krimi i organizuar janë lubrifikantët e modelit ekonomik neoliberal. Sipas nesh, kështu nis shpjegimi për qeverisjet e kaluara.

Thirrjes më shumë shtet e më pak pushtet, i përgjigjemi duke i mohuar të dyjat: më pak shtet, më shumë shoqëri; më pak pushtet, më shumë autonomi.

*Demokracia shoqërore* është përgjigja ndaj atyre që në emër të lirisë individuale dhe nën frikën e kontrollit shtetëror po i hapin rrugë shfrytëzimit të njerëzve dhe pushtimit privat të hapësirës publike. Ajo është mundësia që mirëqenia eventuale të thellohet drejt barazisë shoqërore. Vetëm kur klasat, shtresat e kategoritë shoqërore janë autonome dhe të asociuara mes vete, të drejtat dhe mirëqenia e fituar do të lidhen me to. Kështu, shteti nuk do të mund të luajë rol paternalist në emër të mirëqenies. Demokracia shoqërore dhe autonomia janë negativët e shfrytëzimit ekonomik, por edhe të dominimit politik e ideologjik.

Logjika e kontradiktës monolite prej të cilës buron gjithçka sikur nga mëkati fillestar, bashkë me një përshkrim zhvillimi evolutiv të stadeve drejt çlirimit përfundimtar, kanë përjashtuar nga përpjekja shumë kategori e përvoja të të shtypurve, kurse shumë të tjera i kanë trajtuar në mënyrë instrumentalizuese. Kjo sepse një analizë e tillë na dërgon pashmangshëm në hierarkizimin e çështjeve dhe ndarjen e tyre në kryesore dhe periferike. Për një kohë të gjatë përpjekjet e grave për barazi janë reduktuar nën shpjegimin e shfrytëzimit klasor. Kjo është t'u kërkosh atyre të durojnë e të presin zgjidhjen e çështjes së madhe. Kështu vetë çështja 'e madhe' ka humbur një potencial të madh. Në anën tjetër, përvoja e socializmit shtetëror, me gjithë arritjet në punësim e sferën publike, brenda familjes i ka ruajtur marrëdhëniet patriarkale.



Një grua vritet brenda shtëpisë, një tjetër rrahët publikisht sepse ishte rome, kurse një vajzë ishte dhunuar vazhdimisht, por morali shoqëror e kishte mbajtur të heshtur. Shfrytëzimi kapitalist sot është mirë i përshtatur me patriarkalizmin e mendësinë konservatore. Kjo simbiozë ruan hierarkitë, mbyll e moralizon seksin e familjen. Lufta kundër objektivizimit të gruas e seksualizimit të vendeve të punës; liria për komunitetin LGBTQI dhe pranimi i tyre si pjesë normale e shoqërisë; lufta kundër racizmit dhe të drejtat civile e kulturore për pakicat kombëtare. Këto çështje duhet të jenë pjesë e secilës përpjekje barazitare.

Marrëdhënia klasike e shfrytëzimit klasor, ajo punë - kapital vazhdon të mbetet nga format më të shpeshta, por nuk është më e vetmja si në epokën e industrializmit. Numri i të papunëve, emigrantët, varfërimi i shtresës së mesme, gratë, por mbi të gjitha dinamika intensive e akumulimit dhe krizat e vazhdueshme e bëjnë të domosdoshme punësimin e nocioneve si hegjemonia e tejdeterminimi, përkundër subjektit historik të vendosur njëherë e mirë. Demokracia si hapësirë e zbrazët e mungesë garance është aksioni e hapësira e ndërtimit të hegjemonisë pa përfunduar tek subjekti i premtuar nga historia. Aty, bashkë, në aktivitetet e sipër ndërtohen aleanca e bashkëpunime midis klasave, shtresave e kategorive shoqërore.

Çfarë mbetet nga shteti përtej demokracisë shoqërore e kuptojmë si kontratë shoqërore, dhe jo si *Leviathan*. Jo si arbitër që administron instinktet e veset e presupozuara si të patejkalueshme.

Përgjatë dy dekadave rresht Kosova ka qenë fushë e ristrukturimit neoliberal të ekonomisë. Privatizimi deindustrializues ka shkatërruar potencialin prodhues, ka rritur papunësinë dhe ka atomizuar shoqërinë. Krahas kësaj, politika e taksave të sheshta dhe mungesa e aplikimit të pagës minimale ka rritur pabarazinë.

Përgjatë angazhimit tonë do t'i kombinojmë aktivizmin e aksionin barazitar, me politikat publike e programore. Do të punojmë në dy nivele: hartojmë politika, ndërkohë që anagazhohemi për lëvizje të gjërë shoqërore. Partia Social Demokrate e sheh politikën sociale si pjesë thelbësore të politikës zhvillimore. Kjo politikë zhvillimore do të synojë arritjen e një shkalle shumë të lartë të punësimit, një nivel të lartë të cilësisë së jetesës dhe besimit njerëzor e politik, të përfshirjes së plotë sociale, dhe një shoqërie sa më të barabartë e të vetëdijësuar për barazinë. Këto synime do të arrihen përmes politikave të qarta, unike, të zbatuara me efektshmëri dhe cilësi të lartë qeverisjeje,



të karakterizuara nga parimet e solidaritetit e dekomodifikimit, e jo nga parimet e kushtëzimit, dënimit e stigmatizimit. Këto politika të PSD-së do të jenë:

- shërbimet dominante publike, universale, të financuara nga taksat e përgjithshme dhe të qasshme pa kushte si shërbimi kombëtar shëndetësor, kujdesi afatgjatë, edukimi i hershëm dhe kujdesi ndaj fëmijëve parashkollorë, puna sociale përmes Qendrave për Punë Sociale, dhe shërbimet dinamike të punësimit;
- politikë të punës që forcon rolin e punëtorit, rrit investimin në aftësimin e punëtorëve, demokratizon vendin e punës, dhe rrit peshën e sindikatave në politikbërjen socio-ekonomike;

transferet sociale gjithëpërfshirëse dhe solidare të përbëra nga të ardhurat bazë universale të financuara nga taksat e përgjithshme, që garantojnë standard dinjitoz të jetesës, ndërsa duke shtuar mbi to të ardhura nga Sigurimi Shoqëror financiar nga kontributet mbi parimet e solidaritetit;

- politikë të familjes që mundëson pjesëmarrjen e barabartë gjinore në punë, degjorizon kujdesin social, dhe i kontribuon transformimit të normave sociale sa i takon përgjegjësi dhe pritjeve për punën në shtëpi dhe në dhënie të kujdesit social;
- politikë që krijon strukturë progresive të taksave;
- që komunikon ngushtë me shkencën më të avancuar për tu përmirësuar dhe për t'iu përgjigjur me kohë nevojave dhe rreziqeve të reja;

Një angazhim i tillë krahas lëvizjes shoqërore krijon edhe përfytyrimin për një shoqëri të transformuar. Një shoqëri ku puna matet me përmbushjen e realizimin e gjithanshëm të potencialit njerëzor. Një sistem arsimor ku krahas përgatitjes profesionale, dijet e përgjithshme mbi shoqërinë, botën e natyrën janë të domosdoshme. Ashtu që secili punëtor të jetë i vetëdijshëm mbi efektin që e ka në shoqëri puna e tij. Kështu, duke mësuar hapjen universale të fushave të ndryshme, profesionistët nuk janë më vegla riprodhuese. Një mjek nuk mund të punojë pa imperativin e Betimit të Hipokratit; një urbanist s'mund të mos dijë mbi të drejtën për qytetin, efektet e



gjentrifikimit dhe rëndësinë e hapësirës publike; siç duhet t'i dijë mirë problemet e ndryshimeve klimatike një inxhinier.

Kapitalizmi global po bëhet absolut. Tek përulan resurset, po pushton hapësirë e kohë. Institucionet shtetërore, por edhe e drejta ndërkombëtare janë larg mbrapa ligjit të kapitalit vlerësuar nga pikëpamja e efikasiteti, kurse nën të shikuar nga marrëdhënia e interesat që mbrojnë. Koha është nën hyqmin e tij poashtu. Si orar pune, sfilitës deri në vdekje, e topitës deri në budallepsje; si kohë e lirë, jemi prapë me të. Tek hamë bukën e çlodhemi, mund të jemi në shtëpi të shoqëruar nga veglat e kulturës masive, apo jashtë saj - brenda hapësirave të komercializuara për njeriun konsumues.

E ardhmja e qeverisë të tashmen përmes kredive. Gjithçka që kemi përtej konsumit ditor si ushqim e veshmbathje është e bazuar mbi premtimin e pathyeshëm për punën e premtuar. Pathyeshmëria e premtimit ka zënë të marrë theks më shumë sesa realizimi i punës. Kapitalizmi financiar është emri i sistemit që nuk mbahet më nga puna e llogaritur si normë mbivlere, por nga numri i njerëzve hipotekë.

Shtirja globale e sundimi sistemor, por sidomos natyra e problemeve që ka shkaktuar, po e bëjnë gjithnjë e më të pamjaftueshëm përgjigjen brenda njësisë së kufijve shtetëror.

Papunësia enorme po merr forma të pushtetit biopolitik, me tendencë drejt ligjeve të reja demografike. Ajo na shfaqet si përjashtim në lagjet e jashtme të njerëzve pa letra, deri tek lëvizjet ndërkontinentale të popullsisë që ndjekin vendet e punës. Shtetet veç e veç kanë dështuar ta zgjidhin këtë problem. Më tej, sentimente i prodhuar kundër emigrantëve ka krijuar terren për forcat neo-fashiste.

Vendi ynë Kosova, duke qenë periferi dhe nga vendet me nivelin më të ulët të zhvillimit ndikohet direkt nga këto dinamika. Fenomeni i migrimit në vendet e BE-së për arsye punësimi, por edhe kryerja e punëve të ndryshme që nuk kërkojnë afërsi fizike me lokacionin e punëdhënësit shpjegohet nga dallimi i madh në nivelin e pagave midis Kosovës dhe vendeve udhëheqëse të BE-së.



Për nga përkufizimi, akumulimi i kapitalit është diçka që nuk kryhet. Pas çdo fundi, për të është hapur një fushë e re. Ai edhe mund t'ia bëjë varrin vetvetes, siç pritej dikur. Por, çfarë dimë me siguri është që ky varr tashmë po gërmohet për njerëzimin. Fitimi e akumulimi i fitimit; konkurrenca drejt fitimit maksimal; centralizimi dhe fitimet e monopolit industrial; tek monopoli financiar; pastaj thyerja e monopoleve drejt industrializimit të botës tjetër - kjo nuk është një dramë apokalipsi, por rruga e tragjedisë reale planetare. Nëse nuk ndërmerret diçka shpejt në ndalimin e lirimit të gazrave serë, efekti i tyre drejt ndryshimeve klimatike do ta bëjë planetin të pajetueshëm. Të udhëhequra nga partikulariteti i fitimit vetanak, shtetet nuk po arrijnë të merren vesh për një veprim në shkallë botërore. Pa një veprim të tillë, një shtet i vetëm, sado progresiv qoftë, nuk e adreson dot këtë problem planetar.

Zhvillimi e mirëqenia brenda një shteti është pikëtakimi i së majtës së vjetër dhe forcave të popullizmit të majtë sot. Pretendimi që ne do të ndjekim të njëjtën rrugë e të njëjtët hapa me Perëndimin e shekullit XIX e XX është iluzor dhe i gabuar. Shkalla e përhapjes, ndërthurja e impakti i financave e korporatave multinacionale dikton një përgjigje internacionaliste. Kriza e borxheve në Evropë është një shembull i tillë. Dështimi i së majtës në vendet e goditura nga kjo krizë mban emrin e mungesës së internacionalizmit. Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë në marrëdhënie të varësisë ekonomike përballë Bashkimit Evropian. Jo rastësisht, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga probleme të ngjashme. Bilanci tregtar është negativ, vendet e punës mungojnë, kurse fenomeni i migrimit drejt Evropës Qendrore është në rritje të vazhdueshme. Kjo sepse ne shërbejmë si tregje dhe si vende aksesorë që sigurojnë fuqi të lirë punëtore për qendrën e industrializuar. Ballkani Perëndimor është periferia e Evropës. Popujt e Ballkanit duhet ta shohin e ta kuptojnë që përveçse gjeografia detyron fqinjësi të mirë, ata i kanë po ashtu të njëjtat probleme që nuk i zgjidhin dot veç e veç. Rajoni ynë mund t'i lë mbrapa armiqtë vetëm duke mësuar se ato nuk ishin burim i konflikteve identitare, por rezultat direkt i shtypjes e dominimit.

Guximi për t'i parë në sy këto probleme sjellë perspektivë bashkëpunimi. Një projekt i përbashkët bashkëpunimi midis popujve të Ballkanit për të pasur themele të sigurta duhet të bazohet mbi vullnetin e lirë të asocimit dhe statusin e barabartë të popujve brenda tij; rezoluta e mohuar nga konferenca e Bujanit mbi të drejtën e bashkimit midis Kosovës e Shqipërisë si ushtrim i të drejtës



për vetëvendosje është gur prove për bazat e vërteta internacionaliste dhe garancë për të mos lejuar përsëritjen e Jugosllavisë së Avno-it. Një projekt i tillë nuk duhet të jetë arenë e lirë konkurrence e lufte ku secili merr sipas fuqisë. Përkundrazi, duke e adresuar zhvillimin e pabarabartë dhe marrëdhëniet qendër - periferi, Ballkani mund të bëhet përgjigja model për projektin evropian. Ne duam Evropën e bashkuar dhe mbështesim forcat që synojnë atë. Ajo është e mundur kur nuk do të mbyllet më tek përkufizimi i saj negativ si projekt kundër luftës, por të bëhet projekti afirmativ i paqes së përhershme dhe i jetës së mirë. Një Evropë e bashkuar, federale dhe demokratike është e mundur vetëm nga poshtë: nga klasat e shfrytëzuara, të shtypura e të përjashtuara të shoqërisë. Emigrantët e jashtëm dhe të brendshëm, afrikanë, apo shqiptarë, bashkë me punëtorët vendës evropianë, dhe nën jehonën universaliste të shenjuesit ‘qytetar’ mund ta projektojnë Evropën si projektin e të ardhmes.

Për të mos e mbyllur fushën, në vend se të japim përkufizim që nuk mund të jetë pa mbetje sado i përmbledhur qoftë ai, do të përmendim fjalë që marrin rrugë: çështja, njerëzit, beteja. Një kolektiv që e ndjen thirrjen. Shumësia në veprim që nuk degradon në politikë identitare as nuk mbyllet tek Njëshi: është betejë demokratike, barazitare dhe internacionaliste.

Për ne, veprimi politik është barazitar dhe demokratik. PSD është e majtë dhe demokratike.